


**RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA  
DHE TË SHPENZUARA PËR VITIN 2021 NGA PARTIA “MINORITETI ETNIK GREK  
PËR TË ARDHMEN” (MEGA)  
KOMISIONIT ZGJEDHOR TË ZGJEDHJEVE**

**(Hartuar sipas formatit të standartizuar të miratuar me vendimin nr.10,  
dt.21.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve - KQZ)**





## **AUDITUESE LIGJORE**

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

### **I. Informacion i Përgjithshëm**

#### **A. Informacion ligjor**

##### **i. Kuadri ligjor**

Përmbushja e detyrës sime për kryerjen e auditimit të detyrueshëm të partive politike, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2021, u krye sipas vendimit nr. 150, dt. 26 prill 2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që ka shpallur rezultatin e shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar (auditëve ligjorë), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin 2021.

Realizimi i këtij misioni ka këtë bazë ligjore, si më poshtë renditur:

##### **i. Kuadri ligjor**

- Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar” i ndryshuar;
- Standartet ndërkombetare të auditimit;
- Ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,
- Vendimi nr. 150, datë 26 prill 2022 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për kryerjen e auditimit të detyrueshëm të partive politike, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2021, në përputhje me ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, dhe/ose akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij në lidhje me fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera gjatë vitit kalendarik pararendës, ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar<sup>1</sup> dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, si dhe ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre.
- Udhëzimi nr.10,dt. 21.04.2021 i KQZ-së, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre dhe mënyrën e pagesës së audituesve”.
- Udhëzimi nr. 14, datë 9 qershor 2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore” dhe vendimit nr. 15, dt.26.01.2022 të KQZ-së, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021 2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen

<sup>1</sup> Është shkruar gabim nga KQZ-ja citimi i ligjit: duhet “të audituesit ligjor dhe jo “të ekspertit kontabël të regjistruar”.





## **AUDITUESE LIGJORE**

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”;

- Legjislacioni tatimor në fuqi.

### ii. **Standardet e kontabilitetit të zbatueshme:**

- Në përputhje me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, partitë politike kanë statusin e njësive jofitimprurëse dhe janë objekt i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) dhe specifikisht i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të organizatave jo -fitimprurëse (SKK-ja për OJF-të).

3

## **B. Objekti i auditimit**

### i. **Kontrata e shërbimit**

Kryerja e misionit të auditimit të detyrueshëm të partive politike, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2021 u krye sipas kontratës të lidhur midis KQZ-së, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm i KQZ-së, z. Ylli MERKAJ dhe audituese ligjore, znj. Fatmira KASTRATI (SYKJA), anëtare e IEKA-s, zotëruese e licencës së IEKA-s, me nr. 14, datë 11.01.2000, me NIPT K46523036S.

Objekti i kësaj kontrate është i përcaktuar në nenin 1 të saj dhe ka të bëjë me kryerjen e auditimit të detyrueshëm të partive politike, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2021, në përputhje me ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, dhe/ose akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij në lidhje me fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera gjatë vitit kalendarik pararendës, ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar<sup>2</sup> dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, si dhe ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre.

### ii. **Vendimi i KQZ-së**

Vendimi nr. 150, datë 26 prill 2022 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që ka shpallur rezultatin e shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (auditëve ligjorë), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin 2021, solli lidhjen e kontratës së shërbimit me numër protokollit të KQZ-së 2510, datë 30.05.2022, përshkruar më sipër në pikën i.

Me këtë vendim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve më ka emëruar, me cilësinë e Auditit Ligjor, **të auditoj fondet** e përfituara dhe të shpenzuara nga partia politike MEGA, për vitin 2021.

<sup>2</sup> Është shkruar gabim nga KQZ-ja citimi i ligjit: duhet “të audituesit ligjor dhe jo “të ekspertit kontabël të regjistruar”.





## **AUDITUESE LIGJORE**

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

### **iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor**

Subjekti zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të të dhënave sipas formatit të standardizuar të raportimit financiar dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e raportit financiar që nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Auditimi ynë do të kryhet bazuar në faktin që drejtimi (personi përgjegjës për financat në partinë politike ose personi i përcaktuar sipas statutit të partisë), të pranojë dhe kuptojë se ka përgjegjësi:

- Për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare (raportit vjetor) në pajtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për organizatat jo fitimprurëse (SKK-ja për OJF-të) dhe me kërkesat specifike të ligjit “për Partitë Politike” i ndryshuar, dhe në udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së);
- Për kontrollet e brendshme, të atilla që drejtimi i partisë i konsideron të nevojshme, për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale nga mashtrimi apo gabimi;
- Regjistrin e posaçëm, sipas formatit të miratuar nga KQZ-ja për shumën e fondeve të përfitura nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhënat që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit;
- Deklaratat e dhurimit sipas formatit të miratuar nga KQZ-ja;
- T’i japin audituesit:
  - Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet për të cilat drejtimi ka dijeni se janë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare, siç janë regjistrimet, dokumentacioni dhe çështje të tjera;
  - Informacion shtesë, të cilin audituesi mund ta kërkojë nga drejtimi për qëllime të auditimit;
  - Të drejtën e komunikimit pa kufizim me personat brenda Partisë nga të cilët audituesi e gjykon të nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit ne kërkojmë nga drejtimi i Partisë, kur është e përshtatshme, edhe nga personat e ngarkuar me administrimin që të marrim, prej tyre, konfirmime me shkrim mbi deklaratimet me gojë që do të na bëhen në lidhje me auditimin.

### **iv. Përgjegjësitë e audituesit**

Auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike. Si pjesë e një auditimi, sipas SNA-ve, ne do të ushtrojmë gjykimin profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Si rrjedhojë e kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, së bashku me kufizimet e vetvetishme të kontrollit të brendshëm, ekziston një rrezik i pashmangshëm që disa nga anomali të materiale të mbeten të pazbuluara, edhe pse auditimi është planifikuar siç duhet dhe kryer në përputhje me SNA-të.

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare (raporti vjetor financiar) në tërësi nuk kanë anomali materiale, për



## **AUDITUESE LIGJORE**

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë por, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojë vendimet e përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

### **C. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR**

#### **i. Prezantimi i subjektit politik**

Partia MEGA është krijuar me vendimin nr.5085, me nr. akti 7527, dt. 21.06.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me simbolet MEGA. Kryetari i MEGA-s është z. Kristo Kiço.

Partia është e regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT L04703991T, Sarandë. Adresa zyrtare e Partisë, e shkruar në certifikatën e NIPT-it, lëshuar me datë 15.12.2022, është: rruga e Flamurit, lagja nr.1, Sarandë.

#### **Forma e organizimit dhe menaxhimit të partisë**

Sipas kapitullit V të statutit të partisë “Minoriteti Etnik Grek Për të Ardhmen”, me simbolet MEGA, ka si organe qendrore drejtuese si më poshtë:

1. Kongresi Programor,
2. Keshilli Kombëtar i Përfaqesuesve,
3. Kryesia e Partisë,
4. Komisioni Qendror i Kontrollit dhe Respektimit të Statutit.

### **PREZANTIMI I RAPORTIT VJETOR DHE STRUKTURA E TIJ**

#### **i. Struktura e raportit – këkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet.**

Struktura e raportit vjetor financiar (pasqyrat financiare) të Partisë, të publikuara, përbëhet nga:

- Pasqyra e pozicionit financiar dt.31.12.2021,
- Pasqyrën e performancës (PASH) viti 2021,
- Pasqyra e shënimeve shpjeguese.

#### **ii. Takimet dhe komunikimet midis audituesit dhe subjektit zgjedhor dhe çdo personi tjetër të tretë**

Komunikimi me Partinë u krye nëpërmjet rrugës së postës elektronike me z. Kristo Kiço, zj. Krisanthi Naço dhe z. Tafil Kola dhe nëpërmjet komunikimit telefonik me z. Tafil me nr. 0695143019 . Partia ka dorëzuar pasqyrat financiare të firmosura nga kontabli i Miratuar, z. Tafil Kola dhe kryetari i Partisë, z. Kristo Kiço.



## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

Pasqyrat financiare të vitit 2021 janë të shpallura në faqen zyrtare të KQZ-së<sup>3</sup>.

Auditimi është kryer në zyrën e Auditueses Ligjore përfshirë këtu edhe komunikimin nëpërmjet postës elektronike dhe thirrjeve e mesazheve telefonike.

### iii. Paraqitje e përgjithshme e raportimeve vjetore të partisë politike (nëse është apo jo në përputhje me kërkesat e raportimit)

Ne vlerësuam paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e raportit vjetor (pasqyrave financiare), përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, të publikuara për vitin 2021 nga partia MEGA, nëse ato paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrën që të japin paraqitjen e drejtë. Pasqyrat financiare të paraqitura nga MEGA, nuk janë të raportuara sipas formatit të SKK-së për OJF-të.

6

## I. KËRKESAT FORMALE

### A. PËRMBLEDHJE

1/ Data e dorëzimit të raportit vjetor			
	Dorëzimi fizik	Po	S'ka
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Po	23.03.2022
	Identiteti i nënshkruesit	Po	Emër: Kryetari i Partisë, Kristo Kiço dhe kontabilisti i miratuar, Tafil Kola

### B. CAKTIMI I AUDITUESIT LIGJOR DHE LLOGARISË BANKARE

1/ Informacioni për partinë politike		
Emri i partisë politike	Partia "Minoriteti Etnik Grek Për Të Aardhmen"- MEGA	
Adresa e selisë qendrore	Rruga e Lirisë, lagja nr.1, Sarandë	
Numri i telefonit të selisë qendrore- Përfaqësueses të autorizuar dhe Administratores	Kristo Kiço-Kryetar:0692030036	
Adresa e email-it të selisë qendrore të partisë (nëse ka) <sup>4</sup>	Kico Kristaq <a href="mailto:kicokristaq@yahoo.com">kicokristaq@yahoo.com</a>	
2/ Informacion për audituesin ligjor		
Emri i audituesit ligjor të caktuar	Fatmira Kastrati (Sykja)	
Adresa e audituesit ligjor	Rr. "Milto Tutulani", godina 6, hyr 9, Nj.adm 5, Tiranë	
Numri i telefonit të audituesit ligjor	+355 69 20 86610	
Adresa e email-it të audituesit ligjor (nëse ka)	<a href="mailto:mira_kastrati@yahoo.it">mira_kastrati@yahoo.it</a>	

<sup>3</sup> <https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Raporti-Vjetor-Financiar-i-partise-Minoriteti-Etnik-Grek-per-te-Ardhmen-2021.pdf>

<sup>4</sup> <http://cec.org.al/kandidate-per-kryetar-bashkie/>





## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

### 3/ Të dhënat e llogarisë bankare të partisë politike

Emri i bankës ku mbahet llogaria	OTP Albania
Adresa e zyrës së bankës ku mbahet llogaria	Lagja nr.2, Sarandë, Shqipëri
Numri i telefonit të zyrës së bankës	+355 68 (69) 40 12 121; 08004848
Adresa e email-it të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës	<a href="mailto:info@otpbank.al">info@otpbank.al</a>
Numri i llogarisë bankare	00001776304
Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	

7

### C. AKTIVET DHE DETYRIMET

#### 1/ Kriteret e klasifikimit të aktiveve

Përshkruani natyrën e secilit aktiv, pronë e partisë, në datën e vlerësimit Sipas natyrës, aktivet në datën e mbylljes së pasqyrave financiare 31.12.2021 përbëhen: - Mjetet monetare në arkë që janë 24,758 lekë dhe në bankë 3,091 lekë. - Aktivet afatgjata materiale 0 lekë
Përshkruani vendndodhjen e aktivit - Vendndodhja e mjeteve monetare është në llogaritë bankare tek OTP Albania, Sarandë dhe në arkën e Partisë Vendëndodhja e aktiveve material: nuk ka aktive materiale. - Partia nuk ka aktive në degët e saj nëpër rrethe
Shkruani vlerën e tregut të aktivit, në datën e vlerësimit nëse është bërë vlerësim, ose vlerën kontabël të mbetur.  Vlera kontabël e mbetur e aktiveve është raportuar me dt. 31.12.2021 në vlerën 0 lekë.

#### 2/ Kriteret e klasifikimit të detyrimeve

Përshkruani llojin e secilit detyrim të partisë, në datën e vlerësimit Sipas llojit detyrimet në datën e mbylljes së vitit ushtrimor 31.12.2021 përbëhen nga detyrimet për sig.shoq të muajit dhjetor për 5,120 lekë dhe detyrime furniture 22,729 lekë, gjithsej 27,849 lekë
Shkruani emrin e kreditorit për detyrimet: DRTS për 5,120 lekë dhe 22,729 lekë-nuk ka shpjegim në shënimet shpjeguese.
Shkruani vlerën e detyrimit në datën e vlerësimit dhe kushtet e shlyerjeve : s'ka

### D. PËRMBLEDHJE FINANCIARE

#### Përmbledhje Financiare

Periudha e raportimit (data e fillimit dhe e perfundimit të periudhës që mbulon raportin)	01.01.2021 – 31.12.2021
---	-------------------------





## **AUDITUESE LIGJORE**

**FATMIRA SYKJA - KASTRATI**

**NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000**

Shuma e parave në arkë në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit (data e fillimit dhe e perfundimit të periudhës që mbulon raporti)	Gjendje arka 01.01.2021 = 0 leke Gjendje arka 31.12.2021= 24,758 lekë
Shuma e përgjithshme e të gjithë kontributeve të marra	<i>Të ardhura gjithsej = 70,000 lekë</i>
Shuma e përgjithshme e të gjitha shpenzimeve të bëra.	<i>Shpenzimet gjithësej= 70,000 lekë</i>
Bilanci në fund të periudhës së raportimit (data e fillimit dhe e perfundimit të periudhës që mbulon)	31.12.2021
Shuma e përgjithshme e të gjithë aktiveve në fund të periudhës së raportimit	<i>Aktivet = 27,849 lekë</i>
Shuma e përgjithshme e të gjithë detyrimeve në fund të periudhës së raportimit.	<i>Detyrimet = 27,849 lekë</i>

8

### **a/ Audituesi Ligjor**

- Identiteti i audituesit ligjor
  - Fatmira Kastrati (Sykja)
  - o Çështja e mospërputhjeve të mundëshme  
Bashkëngjitur raportit deklarata e pavarësisë.
- Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit vjetor
  - o Nënshkrimi i raportit vjetor  
Nënshkrimi i raportit vjetor është bërë nga kryetari i Partisë, z. Kristo Kiç dhe kontabilisti i miratuar, z. Tafil Kola.
  - o Paraqitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse: vërejtja e problemeve të dukshme (shiko më poshtë)





## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

a) bosh/mungon informacioni	Jo		
b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
	<b>Të Ardhurat</b>		70,000
		Financime publike	
		Donacione private	
		Financim nga burimet e veta të partisë	70,000
		Hua/Kredi	0
	<b>Shpenzime</b>		
		Shpenzimet e qerasë	
		Stafi / rrogat dhe sig shoq	
		Media	
		Komunikimi	
		Transporti (karburant)	
		Shpenzimet bankare	6,239
		Administrative dhe të	63,761
		Përgjithshme	
		Amortizimi	
		Menaxhimi i Pronës	
		Shpenzime të tjera	

9

### b/ Asetet/detyrimet dhe përmbledhjet financiare

- Çdo mospërputhje / parregullsi në lidhje me deklarin e aktiveve dhe detyrimeve.

Gjatë auditimit të aktiveve dhe detyrimeve është vërejtur që ka detyrime.

Defiçit/ shpenzime të papaguara

Gjatë periudhës 01.01.2021 – 31.12.2021 ka defiçit apo shpenzime të papaguara në vlerën 0 lekë.

## II. TË ARDHURAT

### A. PËRMBLEDHJE

	Sipas raportit	Sipas auditimit të kryer
<b>1/ Financimi publik</b>		
Shuma e granteve publike të marra		
Data e tranfertës		
<b>2/ Donacionet private</b>		
Shuma e përgjithshme e raportuar		
Shuma e donacioneve në para		
Shuma e donacioneve në natyrë	0	0
Paraqitja e një liste të donatorëve		Po

Rr. "Milto Tutulani", godina 6, hyrja 9, kodi postar 1019, Njësia administrative 5, Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail: [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

Paraqitja e të gjitha deklarimeve bankare			
Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar			
Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklarimit bankar (data)			
Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklarimit bankar (donatori)			
Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)			
A përputhen shifrat e përgjithshme?			
Respektimi i kufirit të donacionit			
<b>3/ Financimi nga burimet e vetë partisë</b>			
Shuma e përgjithshme e raportuar	70,000	70,000	
Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)	70,000	70,000	
Kuotat e anëtarësisë	70,000	70,000	
Botimet	Nuk ka	Nuk ka	
Shtypshkronja	Nuk ka	Nuk ka	
Dhënia me qera	Nuk ka	Nuk ka	
Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)	Nuk ka	Nuk ka	
Kuotat e anëtarësisë	Nuk ka	Nuk ka	
Botimet	Nuk ka	Nuk ka	
Shtypshkronja	Nuk ka	Nuk ka	
Dhënia me qera	Nuk ka	Nuk ka	
Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar	Nuk ka	Nuk ka	
Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar		Nuk ka	
<b>4/ Huatë/Kreditë</b>			
Shuma e përgjithshme e raportuar	Nuk ka	Nuk ka	
Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)	Nuk ka	Nuk ka	
Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)	Nuk ka	Nuk ka	
Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi /	Nuk ka	Nuk ka	
<b>5/ Marrja e të ardhurave</b>			
Nëpërmjet arkëtimeve cash	70,000	70,000	

10

### Kontributet e Specifikuara

Rr. "Milto Tutulani", godina 6, hyrja 9, kodi postar 1019, Njësia administrative 5, Tiranë  
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;  
e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail: [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

Kriteret e kontributeve	
Emri i kontribuesit	
Adresa e kontribuesit	Nuk ka
Profesioni i kontribuesit (nëse kontribuesit nuk ka profesion, shkruani "nuk ka profesion")	
Përshkrimi i kontributit (i tillë si "para në dorë" apo "çek" apo "transferte bankare" apo "përshkrimi i kontributit në natyrë")	Nuk ka
Vlera e kontributit (për kontributet në natyrë shkruani vlerën e tregut, që është vlera e sendit nëse shitet në atë gjendje aktuale)	Nuk ka
Data kur është marrë kontributi	Nuk ka

### B. ANALIZA

#### a/ Financimi nga burimet jo publike

##### - Donatorët e lejuar:

o Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar sipas nenit 21 të ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000, ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.02.2011, ligjin nr. 17/2014, datë 20.02.2014, ligjin nr. 25/2014, datë 25.09.2014, ku përcakton se "Lejohen dhuratat dhe ndihmat që vijnë nga parti ose bashkime ndërkombëtare partish, nga organizata e fondacione politike, vendase e të huaja, si dhe nga individë, persona fizikë e juridikë privat vendas" sikurse Neni 23/1 (ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.02.2011) vë në dukje se:

1. Çdo parti politike duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shumën e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çdo rast, dhuruesi, në kohën e dhurimit, nënshkruan detyrimisht një deklaratë dhurimi, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lista e personave, që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse, duhet të bëhen kurdoherë publike.

2. Dhurimi i fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë, duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme, të hapur në një bankë nga partia politike. Personi përgjegjës për financat në partinë politike, brenda tre muajve nga krijimi i partisë politike, deklaron pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve numrin e llogarisë bankare, të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Ndalohet përfitimi i fondeve jopublike, kryer nga subjekte që nuk deklarojnë identitetin e tyre apo identiteti i të cilave është i papërcaktuar qartë nga partia politike përfituese e fondit jopublik.

Partia MEGA nuk ka pasur financime nga burime jopublike.



## **AUDITUESE LIGJORE**

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

Zyra me sipërfaqe 20 m<sup>2</sup>, që përdoret nga partia MEGA, është dhënë nga bashkia e Sarandës me kontratë huapërdorjeje për periudhën 26.08.2021-26.08.2022, e ndodhur në rrugën e Flamurit, lagja nr.1, Sarandë. Është firmosur nga kryetari i Bashkisë së Sarandës, z. Adrian Gurma.

- **Burimet e palejuara**
- **Kontributet në natyrë o Vlerësimi:**
  - o Dallimi mes kontributit në natyrë (dhe mundësisht) financimit dhe veprimtarisë vullnetare
  - o Vlerësimi (rregulli i 10% më të ulët se çmimi i tregut apo mallrave / shërbimeve që arrijnë vlerën më shumë se 50,000 Lekë) → kur partisë i ofrohen mallra apo shërbime falas në një çmim që është 10% më i ulët se çmimi i tregut, dallimi mes çmimit të tregut dhe pagesës së paguar nga partia duhet të pasqyrohet si donacion (së bashku me emrat e donatorëve nëse ky dallim e kalon shumën 100,000 Lekë).
  - o Çmimi i tregut të mallrave dhe shërbimeve duhet të përcaktohet nga referenca e indeksit të çmimeve mujore të botuar nga INSTAT në kohën kur janë dhënë/ofruar mallrat/shërbimet. Në rast se indeksi nuk përfshin mallrat/shërbimet e ofruara, partia politike duhet të llogarisë çmimin e tregut duke u bazuar në mesataren e çmimeve të tre ofruesve të ndryshëm të mallrave/shërbimeve në kohën kur ato janë ofruar.
- **Kufizimet**
  - o Kontrolli i shumës së përgjithshme nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror nga një degë e partisë;
  - o Kufizimet (pragu i raportimit dhe deklarimit zbatohet si për kontributet në para ashtu edhe për ato në natyrë).

### **b/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike**

- **Klasifikimi me zëra i të ardhurave nga burimet e vetë partisë**
  - o Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe ndarja e shumave të marra = 70,000 lekë
  - o Botimet = 0 lekë
  - o Shtypshkronjat = 0 lekë
  - o Marrja me qira..... = 0 lekë
- **Klasifikimi në bazë të emrit të degës i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar**
  - o Zyra Qendrore = 0 lekë
  - o Degët lokale = 0 lekë
- **Përputhshmëria mes natyrës së të ardhurave dhe shumës së deklaruar dhe deklarimit bankar.**
- **c/ Huatë/Kreditë**
  - Identiteti i huadhënësit/ve *Nuk ka*
  - Shuma dhe data e huasë/ve (paraqitja e kontratës së kredisë / huasë). *Nuk ka*



## **AUDITUESE LIGJORE**

*FATMIRA SYKJA - KASTRATI*

*NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000*

- Data e shlyerjes e përcaktuar në kontratën e kredisë/huasë/ve (problemi i huave të fshira– në rast dyshimi, e rëndësishme që të theksohet) Nuk ka
- Normat e interesit Nuk ka



# AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

## III. SHPENZIMET

### A. PËRMBLEDHJE

Shpenzimet e bëra nga Zyra Qendrore e partisë							
	Shpenzimet e deklaruar në raportin vjetor	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzimet të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentat e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Shpenzimet e qirasë		Ambiente të dhëna nga bashkia Sarandë			Nuk ka		
-Qiramarrja e ambienteve							
- Shërbimet komunale:							
-energja			0				
- uji							
- telefoni							
Stafi/ rrogat dhe sig shoqërore	63,761	Listëpagesat		Nuk ka	Nuk ka	-202,921.84	266,682.84
Media	0			Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	
Komunikimet	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
- Botimet	0			Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
- Materialet promovuese	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
-Sondazhet e opinionit publik/Konsulenca	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
Transporti (Karburant)		0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
			0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	
Automjetet me qera dhe karburanti	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
Akomodimi							

14

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira.kastrati@yahoo.it](mailto:mira.kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira.kastrati@hotmail.it](mailto:mira.kastrati@hotmail.it)





## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

Vaktet dhe shpenzime të							
ppaparashikuara	0			Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
Shpenzimet bankare	6,239	Dokumenti bankar		Nuk ka	Nuk ka	+239	6,000
Administrative dhe të përgjithshme				Nuk ka	Nuk ka		
Amortizim		Kontabilit	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	
Menaxhim i Pronës	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	
Shpenzime të tjera-detyrimet ndaj organeve fiskale	0	Detyrimet në kohë reale tëshpallura në llogarinë e tatimeve të partisë MEGA me dt. 14.12.2022			a	-58,509	58,509

15

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira.kastrati@yahoo.it](mailto:mira.kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira.kastrati@hotmail.it](mailto:mira.kastrati@hotmail.it)







## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

Shpenzimet e bëra nga degët e partisë							
	Shpenzimet e deklaruar në raportin vjetor	Faturat e paraqitur	Faturat e Përgjiths	Dokument et mbështetë	Shpenzi met të papaguaet	Mospërpu thje në lidhje me dokument	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Shpenzimet e qerasë							
-Qiramarrja e ambienteve - Shërbimet komunale: - energjia - uji - telefoni							
Stafi/ rrogat							
Media							
Komunikimet 1- Botimet 2 Materialet promovuese							
Transporti 1- Automjetet me qera dhe karburanti							
2- Akomodimi							
Shpenzimet bankare							
Administrativ e dhe të përgjithshme							
Amortizim							
Menaxhim i Pronës							
Shpenzime të tjera							

Të gjitha shpenzimet e kryera të paguara përmes një llogarie të veçantë

Po

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





## A. ANALIZA

a/ Analiza e të gjitha shpenzimeve të deklaruara dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë:

Nuk ka të dhëna për shpenzime të bëra nga degët e partisë në rrethe.

- **Shpenzimet e qiramarrjes**
  - Marrja me qira e ambienteve
  - Shërbimet komunale (energji, uji, telefoni)
- **Stafi/ rrogat:**
- **Media**
- **Komunikimi**
  - Botime
  - Materiale promovuese
  - Sondazhe të opinionit publik / konsulenca
- **Transport**
  - Marrja me qira e automjeteve dhe karburanti
  - Akomodimi
  - Vaktet dhe shpenzimet e paparashikuara
- **Shpenzimet bankare**
- **Administrative dhe të përgjithshme**
- **Amortizimi**
- **Menaxhimi i pronë**
- **Shpenzime të tjera**

## b/ Verifikimi

- Risqet
- Risqet kryesore të auditimit në lidhje me shpenzimet e partisë janë se:
  - Shpenzimet deklarohen më të ulëta
    - Ka shpenzime të padeklaruara për pagat e Kryetarit të Partisë të raportuara në listëpagesat e dorëzuara në organet fiskale.

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





- Ka detyrimet tatimore të llogaritura të palikuiduara dhe të paraportuara në pasqyrat e saj financiare për vlerën 58,509 lekë deri me 14.12.2022.

Për vitin 2021 i është vendosur detyrim për tatim fitim të vitit 2017 në vlerën 18,495 lekë dhe ,duke zbritur gjobat 60,000 lekë të vendosura në vitin 2022, mbetet detyrimi i llogaritur për vitin 2021 ndaj organeve fiskale në vlerën 58,509 lekë;

- Shpenzimet nuk shoqërohen nga një faturë e vërtetë;
- Informacioni për shpenzimet e partisë përfshin jo vetëm aktivitetet e përditshme të partisë por gjithashtu edhe shpenzimet që kanë të bëjnë me një fushatë zgjedhore në vitet zgjedhore.

Gjatë periudhës ushtrimore 01.01.2021 – 31.12.2021 ka patur fushatë zgjedhore të dt. 25.04.2021, fushatë në të cilën MEGA nuk ka marrë pjesë.

- Në mënyrë që të dokumentohen mirë financat e partisë politike nevojitet përdorimi i metodave standarde të auditimit. Në kontekstin e financave të partisë politike, metodat e mëposhtme janë shembuj i hartimit të metodave të tilla për specifikat e financave të partive politike:

- Shqyrtoni një kategori të deklaruar të përzgjedhur të pagesave (për shembull për komunikimet) të krahasuar me dokumentacionin mbështetës/evidencat (faturat);

MEGA ka paraqitur dhe ka regjistruar në pasqyrat financiare pagesat e detyrimeve të saj të kryera nëpërmjet llogarisë bankare. Veprimet e regjistruara në ditarin e bankës jepnin likuidimet e sigurimeve shoqërore. Për këtë u mor dhe u shqyrtua kartela e llogarisë së bankës. Nuk ka likuidim të pagave nëpërmjet llogarisë bankare.

- Raportimi i shpenzimeve në natyrë. Duhet të ketë një përputhje me donacionet në natyrë.

Gjatë vitit 2021 MEGA ka patur donacione në natyrë sipërfaqen e zyrës të marrë në huapërdorje nga bashkia e Sarandës, sipas kontratës së datës 26.08.2021.

Nuk ka paraqitur as të ardhura në natyrë dhe as shpenzime indirekte në vlerën e donacioneve në natyrë në pasqyrat financiare të vitit 2021.

## V. PËRFUNDIMI

### A. SINTEZA

#### a. Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve

Pasqyrat financiare të partisë MEGA, për vitin 2021, bashkëngjitur, nuk paraqiten në formatin e standartizuar të përcaktuar në SKK-në për OJF-të i shpallur në faqen zyrtare të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

#### b. Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit

Gjatë procesit të auditimit janë gjetur këto parregullsi:

- Pasqyrat financiare nuk janë paraqitur sipas kërkesave ligjore të SKK-së për OJF-të.

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira.kastrati@yahoo.it](mailto:mira.kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira.kastrati@hotmail.it](mailto:mira.kastrati@hotmail.it)





- Si rrjedhojë e paraqitjeve jo të drejta të posteve të pasqyrave financiare, Partia nuk paraqitet gjendja e aktiveve neto të saj.
- Mungon pasqyra e likuiditeve;
- Nuk ka paraqitur as të ardhura në natyrë dhe as shpenzime indirekte për periudhën 26.08.2021-31.12.2021 vlerën e ambientit të zyrës që MEGA ka marrë në huapërdorje nga bashkia e Sarandës, sipas kontratës së datës 26.08.2021;
- Partia MEGA nuk jep informacion për përdorimin e zyrës për periudhën 01.01.2021-26.08.2021 nëse ka pasur këtë ambient apo ndonjë tjetër dhe kushtet e përdorimit të saj;
- Pasqyra e shënimeve shpjeguese të saj nuk jep informacionet e duhura dhe nuk është në zbatim të Udhëzimit për zbatim për OJF-të, të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të shtatorit 2018.<sup>5</sup>
- Meqë shënimet shpjeguese nuk janë hartuar sipas kërkesave ligjore, mungon edhe informacion në lidhje me sigurinë e vazhdimësisë së Partisë, sipas Udhëzimit për zbatim për OJF-të të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të qershorit 2020<sup>6</sup>.

## B. PËRFUNDIMI

### o Çertifikimi me përmirësime / rezerva

Të nderuar zotërinj,

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të partisë MEGA, për vitin 2021, që përmbajnë:

1. Pasqyrën e pozicionit financiar të dt. 31.12.2021,
2. Pasqyrën e performancës ose të aktiviteteve të vitit 2021,
3. Pasqyrën e shënimeve shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, në bazë të shpjegimeve të dhëna tek baza e opinionit për përmirësime, pasqyrat financiare të dorëzuara nuk janë hartuar nga partia MEGA në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit të tyre.

### Baza e opinionit për përmirësime

Pasqyrat financiare duhet të hartohen sipas kërkesave të SKK-së për OJF-të.

Opinioni ynë është modifikuar për këtë çështje.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga partia politike dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare,

<sup>5</sup> [https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/Udhezuesi%20per%20OJF%20i%20ndryshuar\\_publicuar%202018%20.pdf](https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/Udhezuesi%20per%20OJF%20i%20ndryshuar_publicuar%202018%20.pdf)

<sup>6</sup> [https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/Udhezuesi%20per%20raportin%20e%20performances\\_publicuar.pdf](https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/Udhezuesi%20per%20raportin%20e%20performances_publicuar.pdf)

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira.kastrati@yahoo.it](mailto:mira.kastrati@yahoo.it); e-mail: [mira.kastrati@hotmail.it](mailto:mira.kastrati@hotmail.it)





## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

raporteve financiare. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

## AUDITUESE LIGJORE

Fatmira KASTRATI (SYKJA)

20

Tiranë, më 23 dhjetor 2022



Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,  
Njësia administrative 5 - Tiranë  
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;  
e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)

